



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.140, datë 06.06. 2022

PËR

**“MIRATIMIN E PROGRAMIT QË PËRCAKTON LISTËN E PROKURORËVE, PËR TË CILËT DO TË KRYHET VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL INDIVIDUAL PËRGJATË VITIT 2022”**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a” të Kushtetutës, në nenet 159, pika 2, germa “a” dhe “e”, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “c”, të ligjit Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenet 68, 84, 85 dhe 97, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë programin që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional individual përgjatë vitit 2022, sipas aneksit Nr.1 bashkëlidhur relacionit.
2. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore dhe Prokurorët e komanduar pranë Këshillit pjesë e kësaj njësie, për ndjekjen e këtij procesi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 06.06.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

Alfred Balla

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj





**ANËTAR**  
**Sokol Stojani**

**ANËTAR**

**Bujar Sheshi**

**ANËTAR**

**Nurihan Seiti**

**ANËTAR**

**Elaida Goxhi**

**ANËTAR**

**Esmeralda Keshi**

**ANËTAR**

**Ludovik Dodaj**

**ANËTAR**

**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**

**Mirela Bogdani**